

Fjalë të Mëdha – Pjesa 1

Mirë se erdhe në festimin e kishës sonë. Uroj dhe lutem që Perëndia të të flasë me një fjalë specifike që shkon me situatën ku je sot.

Sot fillojmë një seri të re: Fjalë të Mëdha. Ky është emri i serisë së re dhe do ta quajmë kështu, me gjithë mend. Do të shikojmë për disa të diela radhazi: Çfarë thotë Bibla për jetët tona? Çfarë dëshiron Perëndia nga ne si individë dhe nga ne si kishë?

Nëse çdo të diel do të bëja një lutje, cila do ishte e para? Këtë herë do të lutesha: **Perëndi, na bëj të rrezikshëm.**

Dhe kjo ndodh kur e marrim Perëndinë seriozisht, kur e vendosim Jezusin të parin e jetës tonë, para çdo gjëje tjetër. Mos u ngut ta keqkuptosh fjalën "i rrezikshëm"; më dëgjo se çfarë nënkuptoj me të. Nuk do të thotë të veprosh pa menduar. Do të thotë të marrësh seriozisht atë që të thotë Perëndia.

Sinonimi që përdoret për dikë që është shumë i zoti, është "zjarr fare"; është shumë i përkushtuar në një gjë, është: "Ky është i rrezikshëm! Për atë punë është ai, ai është i rrezikshëm."

Do të shikojmë një pjesë nga Bibla, Ungjilli i Lukës, kapitulli 7. Aty janë tre gjëra, tri hapa, sesi mund të bëhemi të rrezikshëm personalisht dhe sesi të jemi kishë e rrezikshme për Perëndinë.

Gjëja e parë është: Ne bëhemi të rrezikshëm:

Kur Ecim Çdo ditë me Jezusin.

A do të jesh i vakët, i ngrohtë, apo do të jesh i zjarrtë në Zotin, në flakë, të jesh i rrezikshëm? Fillon me ecjen çdo ditë me Jezusin, duke e ndjekur Atë dhe duke e marrë seriozisht fjalën e Tij.

Ja si thuhet te Luka 7:

Luka 7:11 *'Dhe të nesërmen ai shkoi në një qytet që quhej Nain; dhe bashkë me të shkonin shumë nga dishepujt e vet dhe një turmë e madhe.'*

Çfarë bënin dishepujt dhe turma e madhe? Ecnin bashkë me Jezusin, shkonin kudo që shkonte Ai.

Dhe të nesërmen... Po mirë, çfarë ndodhi deri në këtë pikë? Kur fillon kështu, të jep idenë që ka ndodhur diçka më parë, kjo mbaroi, pastaj të nesërmen...

Ungjilli i Lukës është shkruar nga doktor Luka. Ai shkoi dhe takoi vetë dëshmitarët okularë, ata që e kishin parë dhe jetuar me Jezusin. Takoi Marinë, dishepujt dhe të tjerë.

Në kapitujt 1, 2 dhe 3, Luka flet për ardhjen e Jezusit në tokë. Në kapitullin 4, Jezusi fillon shërbesën e Tij; së pari shkoi në shkretëtirë për 40 ditë. Pastaj fillon të mësojë dhe të bëjë mrekulli. Ai shëron një njeri nga lebra dhe një tjetër që ishte i paralizuar. Në kapitullin 6, dikush i bën Jezusit disa pyetje dhe Ai jep disa mësimë shumë të veçanta. Në gjashtë kapitujt e parë kanë ndodhur shumë gjëra të bukura.

Dhe pastaj vjen kapitulli 7 që po lexojmë ne. Në fillim të kapitullit, Jezusi shëron dikë "wireless". Shëron një njeri në distancë; centurioni romak shkon te Jezusi dhe i kërkon të shërojë shërbyesin e tij të sëmurë. Jezusi shkon, por centurioni i thotë se nuk është i denjë që Jezus të hyjë në shtëpinë e tij. Dhe Jezusi e shëron shërbyesin në distancë. Kjo është një histori shumë e bukur.

Të nesërmen, pra pasi kishin ndodhur këto gjëra—Jezusi kishte predikuar dhe turmat ishin mahnitur, kishte bërë mrekulli dhe njerëzit ishin mahnitur akoma më shumë—në vargun 11, Jezusi shkoi në një qytet që quhej Nain. Ky qytet ishte një vend i thjeshtë; në atë kohë, qytetet ngjanin si fshatra sot—një grumbull shtëpish në një kodër, në faqen e malit. Ky qytet nuk përmendet shumë në Bibël përveçse në këtë histori. Dhe çuditërisht, emri i tij, Nain, në gjermanisht tingëllon si "jo"—pra, ku po shkon, në qytetin Nain.

Kur lexon këtë varg, sheh dy grupe njerëzish: dishepujt e Jezusit dhe një turmë të madhe që e ndiqte. Pse kishte kaq shumë njerëz që po e ndiqnin Jezusin? Çfarë po thoshin ata? Ishin njerëz që e kishin parë Jezusin dhe donin të mësonin më shumë prej Tij. Kishin pritshmëri të mëdha—dëshironin të dëgjonin më shumë, të përjetonin më shumë, të merrnin më shumë nga Ai.

Mund të ketë pasur biseda mes tyre, si për shembull mrekullitë që kishte bërë Jezusi. "A e pe se çfarë bëri Jezusi kur shëroi lebrozin?" Lebra ishte një sëmundje e rëndë e lëkurës që shkaktonte humbje të pjesëve të trupit, si gishta që mund të binin. Ky lebroz ndoshta nuk do të shkonte dot në një mbremje maturantësh, pasi kishte humbur disa gishta nga lebra dhe nuk mund të mbante gotën. Por ja që Jezusi e shëron dhe ai tani kishte të gjitha gjymtyrët e tij në rregull—të gjithë gishta të rikuperuar dhe gati për të bërë namin në ndonjë ngjarje si mbrëmja e maturës.

Pastaj Jezusi ka shëruar një të paralizuar. Ky djali ka një jetë që nuk lëviz. Dhe Jezusi e shëron me një fjalë, "Cohu dhe Ec." Dhe atij iu forcuan nyjet dhe brofi në këmbë dhe filloi duke kërcyer nga gëzimi. Gjëra që njerëzit nuk i kishin parë më parë.

Pastaj Jezusi fillon të mësojë. Dhe njerëzit mahnitëshin kur fliste Ai, sepse të jepte ndjesinë: Po je afër Jezusit, diçka do të ndodhë gjithnjë. Një fjalë që do të

ndryshojë drejtimin e jetës. Një mrekulli që do të mahnisë dhe do të kuptosh fuqinë dhe madhësinë e Tij.

Dhe shumë njerëz, turma shkonin pas Tij. “Nuk e njohim mirë, por aq sa kemi parë, ia vlen ta ndjekësh. Sepse kur je afër Tij ndodhin gjëra të papara më parë, kështu që unë s’do i ndahem këtij njeriu”, turma e ndiqnin.

Kështu duhet të jemi të gjithë ne, edhe ti që je këtu. Synimi ynë është të tregojmë se çfarë thotë Bibla për jetën tënde, të njohim Jezusin më shumë. Sa herë që vjen, eja me pritje. Prit që Perëndia të të thotë diçka të re sot.

Ajo që dëgjove javën e kaluar ishte për atë javë. Sot, prit diçka të re. Nëse bëhesh i vakët, dhe nuk ndihesh i rrezikshëm, të bie zjarri dhe pasioni...

“S’ka gjë që s’shkova në kishë sot, do shkoj një ditë tjetër.” “S’ka gjë që ka kaluar gjysma e mesazhit, s’ka gjë që jam vonë.” Nuk është mirë të fillosh të shikosh nga mesi. Pritjet janë shumë të vogla, po u bë, mirë, po nuk u bë, s’ka gjë. Duket sikur është më normale të jesh 5 apo 10 minuta pas fillimit të festimit sesa 5 apo 10 minuta para se të fillojë?

Por, nuk sillemi kështu kur shkojmë në kinema. Në Cineplexx, kur shkojmë, nuk shkojmë vonë pasi ka filluar filmi. Jo, shkojmë 30 minuta para, marrim biletat, marrim një tas të madh me kokoshka, rrimë në radhë, pastaj hyjmë brenda dhe presim 15 minuta reklama përpara se të fillojë filmi.

Nuk do të shkoje vonë në koncertin e Alban Skënderaj ose të një këngëtari tjetër. Por për festimin e kishës, është më e pranueshme të thuash: “Shkoj më vonë.” “E diskutojmë nesër mesazhin me familjen, grupin e vogël, kam kohë këtë javë.”

Nëse thua, "**Unë ec çdo ditë me Jezusin,**" duhet të kesh një ndjesi pritjeje çdo herë që ndjek festimin e kishës. Sa herë që kap Biblën me dorë, duhet të ndihesh se diçka e re do të ndodhi. “Mezi pres që Perëndia të më thotë diçka të re sot, çdo herë që e kam Biblën në dorë, çdo herë që ulem për të ndjekur një festim.” Fakti që po ecën çdo ditë me Jezusin, të jep ndjesinë se diçka e re do të ndodhë sot, diçka që nuk ka ndodhur më parë. Dhe kjo ndodh kur ecën me të, shkon me të krah për krah. A je ti i tillë? A ke pritje sot?

Prit, sepse ishte dhe një turmë tjetër në historinë e Jezusit.

Luka 7:12 *'Dhe, kur iu afrua portës së qytetit, ja që po çonin për ta varrosur një të vdekur, djalin e vetëm të nënës së tij, që ishte e ve; dhe një turmë e madhe nga qyteti ishte me të.'*

Pra ishin dishepujt dhe një turmë që ecte me Jezusin dhe kishte pritje se çfarë do të bënte Jezusi nga momenti në moment. Kur ata shikonin diçka, ishin: "Ja, prit, prit, mos e hap telefonin, shttt, diçka do të ndodhë, qetësi, Jezusi po flet..."

Por ishte dhe një turmë tjetër që po shoqëronte funeralin e kësaj nëne, funeralin e djalit të vetëm. Dhe turma e dytë ishte e shqetësuar, ishin të tensionuar. "Ne u lutëm, Perëndia nuk u përgjigj. Ai mund ta kishte shëruar këtë bir që shtrihet sot në arkivol. Perëndia mund t'ia kishte ruajtur jetën atij." Ishin të tensionuar dhe me kokë të ulur. Nuk e kishin mendjen te Jezusi, e kishin mendjen te ajo që po ndodhte në atë moment, dhe ajo që po ndodhte ishte e zyrtë, e trishtuar...

Ka shumë gjasa që dikush po dëgjon tani dhe nuk ke asnjë sens pritjeje nga Perëndia. Madje po mendon: *"Ore, ku është Perëndia? Unë u luta, por nuk ndodhi gjë. Po tensionohem përditë. Po vuaj përditë, janë në pikë të hallit, përditë."*

Ti mund të kesh shumë arsye pse je i shqetësuar. Por turma e shqetësuar nuk po e shikonte se kush po vinte drejt tyre. E kishin kokën poshtë.

Dikush po dëgjon tani dhe dua të të nxis, është koha të dalësh nga zona e shqetësimit dhe të kesh sensin e pritjes. "Perëndia do të bëjë diçka të re për mua sot." Nëse shqetësimi ta ka ulur kokën, hallet ta kanë ulur kokën, dhe gjërat që nuk po marrin drejtim ta kanë ulur kokën, shiko, sot Jezusi po vjen drejt teje. Ai e di ku je. E di çfarë po kalon. Jezusi shkoi në një qytet të humbur që quhej Nain. Kudo që ti je sot, Ai e di saktësisht se ku je. Sepse ti je bir i Tij, bija e Tij. Ai po vjen drejt teje. Ngrije kokën dhe shiko drejt Tij.

Nëse do të kesh një jetë të zjarrtë, të rrezikshme, së pari duhet të ecesh çdo ditë me Jezusin. Mos prit që jeta do të sjellë rezultate të ndryshme nëse ti po bën të njëjtat gjëra. Çohu dhe bëj diçka ndryshe sot. Thuaj, "Unë do të eci me Jezusin çdo ditë." Jeta jote bëhet e rrezikshme, bëhet energjike, bëhet aventurë e re, kur së pari ti zgjedh: "Unë do të ec me Jezusin çdo ditë."

Cila është e dyta?

Kur Jam Gati Ta Dëgjoj Jezusin

A dëshiron një lloj jete tjetër, një jetë me vrull të ri, zjarr të ri, jetë e rrezikshme? Ji gati për ta dëgjuar atë.

(Shënim për pastorin: mund të tregoni një rast personal

Nuk e di nëse të ndodh ty, por unë jam egoist kur vjen puna për disa gjëra. Disa herë, gruaja ime, më tërheq vëmendjen: "Ej, fokusohu te gjërat kryesore."

Gruaja si zëri i Frymës...)

Siç ma tërheq vëmendjen gruaja ime, kështu bëri edhe Jezusi:

Luka 7:13 *'Posa e pa, Zoti pati dhembshuri për të dhe i tha: "Mos qaj!"'*

Shiko, nëse ke qenë në funerale, njerëzit shpesh thonë gjëra të kota. "Sa i bukur është arkivoli," por çfarë rëndësie ka kjo, kur pas pak do të futet në dhe? "Sa të bukura janë lulet, ku i bleve?" Po, po, ata kanë humbur dikë të dashur, njerëzit flasin kodra pas bregut.

Por Jezusi i tha: "Mos qaj." Si mund të thuash "Mos qaj" në një moment të tillë? Kishte humbur djalin e vetëm, është e pamundur të mos qante. Nëse ti ke humbur një person të dashur dhe dikush të thotë "mos qaj," të vjen t'i thuash: "Çfarë të bëj, të qesh, të hedh valle? Po më thua vazhdimisht 'mos qaj', si mund të ndalem? Më lër rehat, se do të të bëj dhe ty të qash."

Por çfarë i thotë saktësisht Jezusi kësaj gruaje? "Unë jam këtu dhe jam më i madh sesa problemi që po kalon ti. Prandaj, mos qaj."

Ka mundësi që ti po dëgjon tani dhe arsyeja pse nuk ke pritje nga Perëndia është se i ke sytë nga halli që të ka zënë dhe nuk je i fokusuar te Ai që është përpara teje. Jezusi të thotë: "Mos qaj, mos u tremb, mos u shqetëso. Unë jam këtu, jam më i madh sesa nevojat e tua. Jam më i fuqishëm se sfida jote."

Me shumë gjasa, kjo grua nuk e dinte se me cilin kishte të bënte. Por kur Jezusi tha "Mos qaj", ndoshta turma ka thënë: "Po ik, na lër rehat, ne jemi në funeral dhe ti thua mos qaj. Çfarë të bëjmë, të këndojmë tallava? A është ky ndonjë i huaj që nuk e njeh askush në fshatin tonë?"

Por prit, tani merr situata ndryshe:

Luka 7:14 *'U afrua, preku arkivolin, dhe ata që e bartnin u ndalën; atëherë ai tha: "Djalosh, unë të them, çohu!"'*

Prit pak. Arsyeja pse ata që e bartnin arkivolin u ndalën ishte sepse u trembën. Jezusi ishte mësues dhe rabi në atë kohë, dhe hebrenjtë, sidomos mësuesit, nuk preknin asnjë gjë të vdekur. Nëse ndodhte të preknin pa dashje, ishin të papastër për 7 ditë.

Ka shumë gjasa që dikush po dëgjon tani dhe mendon: "Unë kam mëkatuar aq shumë, kam bërë kaq shumë prapësi. Po më kujtohen të gjitha një e nga një. Nuk ka shans në botë që Jezusi do të më prekte mua, do të ndalonte për mua."

Prit pak. Jezusi nuk trembet nga ajo që ke bërë ose ku je. Ai nuk shqetësohet për të kaluarën tënde. Ai nuk i friksohet asaj që ke bërë. Sepse Ai shikon, jo vetëm ku je tani, por edhe kush mund të jesh.

Nuk ka asnjë njeri në botë që Jezusi të mos dojë ta prekë. Ai dëshiron që çdo njeri të ketë një fillim të ri, një jetë të re.

Jezusi e preku arkivolin, dhe njerëzit u ndalën. Pastaj Ai i tha: **“Djalosh, të them, çohu.”**

Prit pak. Si thamë, janë dy turma që po shikojnë:

Oooo, prit pak, Jezusi i tha të ngrihej. Çfarë do të ndodhë? A do të ndodhë ndonjë mrekulli tjetër? Po shiko sesi kjo është diçka që nuk e kemi parë ndonjëherë. Ia vlejti që po ecim me Jezusin. Shiko çfarë do kishim humbur po të mos ishim me të.

Ndërkohë, turma tjetër mund të ketë thënë: *“Ky ka ikur nga trutë, çfarë janë këto lojëra, pse po luan me ndjenjat e kësaj gruaje të varfër?”*

Jezusi i foli një trupi të vdekur dhe e urdhëroi të bënte diçka që fizikisht ishte e pamundur. Jeta jonë bëhet e rrezikshme, një aventurë e re dhe super energjike, kur, së pari, e ecim me Jezusin çdo ditë dhe dëgjojmë çfarë thotë Ai.

E treta...

Kur Besoj Te Jezusi

Miq, jeta jonë do të jetë e rrezikshme. Kisha jonë do të jetë e rrezikshme kur dëgjojmë zërin e Shpëtimtarit që na kërkon të bëjmë të pamundurën dhe jemi plot besim, sa që hedhim hapin sepse dëgjuam zërin e Tij. Po nuk ndalon aty... siç tregon historia në Luka 7.

Për ty që po dëgjon tani, ka shumë gjasa që Perëndia të ka sfiduar për të hedhur një hap besimi, një hap përtej. Cili është ai hap? Çfarë të ka kërkuar Perëndia?

- Ti po ecën me të çdo ditë, ke dëgjuar çfarë të tha; tani është momenti të besosh, të ngrihesh dhe ta zbatosh praktikisht atë që të tha.

Çfarë po të thotë këto ditë? Çfarë po i thotë kishës sonë?

Cili është minimumi që mund të bësh për dikë?

- Merr dikë në celular, fto dikë në festimet e kishës.
- Mendo diçka praktike për dikë.
- Bëhu pjesë e një grupi të vogël.

Nuk do të jemi të rrezikshëm nëse qëndrojmë në vend-numëro. Vend-numëro është vakësi. Le të jemi zjarr.

Le të ecim me Jezusin çdo ditë. Le të dëgjojmë çfarë të thotë Ai kur shikojmë një festim, kur lexojmë Biblën. Dhe le të bëjmë diçka.

Shumë thonë, "E dua Jezusin, Jezusi, Jezusi."

POR pyetja mbetet: A beson me të vërtetë te Ai? Sepse një kishë që është e rrezikshme është ajo që beson. Ecën, dëgjon, beson.

Pyetje për çdo person: A beson se "The Best Is Yet To Come"? (Më e mira nuk ka ndodhur akoma, po vjen, është rrugës?)

Po apo jo?

Ku e lamë? Jezusi i tha djalit, " Çohu."

Luka 7:15 *'Dhe i vdekuri u çua ndenjtur dhe filloi të flasë. Dhe Jezusi ia dha së ëmës.'*

Çfarë ndodhi, si ndodhi? Po mirë, ç'ka thënë, jam kurioz. Dhe thuhet se *filloi të flasë*. Po të ishte në ditët tona, do të thoshim, "Kush ma mori telefonin, ku e kam telefonin?"

Imagjino, je në një funeral, dhe ai që flet në funeral: *Jemi mbledhur këtu për t'i dhënë lamtumirën e fundit... prit pak, prit pak. Se nuk qenka fundi. Mos, u çua ky ore. O Jezus, ç'po bën kështu? Po prishe funeralin.*"

Çfarë do të ketë thënë ai djaloshi, jam shumë kurioz të di?

Do t'i ketë thënë, "Ç'kemi plako, toke këtu! Të kam një përqafim borxh."

Edhe një herë:

Luka 7:15 *'Dhe i vdekuri u çua ndenjtur dhe filloi të flasë. Dhe Jezusi ia dha së ëmës.'*

Prit pak, vargu 16 është fantastik fare:

Luka 7:16 *'Atëherë të gjithë u mrekulluan dhe lëvdonin Perëndinë duke thënë: "Midis nesh doli një profet i madh" dhe: "Perëndia e vizitoi popullin e vet".'*

Sa veta u mrekulluan? Të gjithë, ata që ecën me Jezusin dhe banorët e qytetit Nain, të gjithë.

Unë i lutem Perëndisë, *Perëndi të përgjërohem, mbushe jetën e çdo personi që po na ndjek tani me praninë Tënde, që çdo person që të njih të mrekullohet nga fuqia Jote në jetën e tij. Perëndi, bëj të mundur që çdo person i kësaj kishë të ecë me Ty, të përjetojë Ty në atë lloj forme, sado që të përjetojë mrekulli dhe fuqinë Tënde. Aq sa kushdo që i njih në familje ose shoqëri do të mrekullohet*

prej gjërave që Ti po bën tek ata, saqë do të thonë, "Ne s'kemi parë një njeri të tillë." Dhe ata që nuk të njohin Ty, Jezus, do të thonë: "Nëse Perëndia është i tillë, unë e dua këtë Perëndi."

Miq, nëse mbushemi me Perëndinë, problemet tona do të duken të vogla.

Ata, të gjithë u mrekulluan dhe lavdëruan Perëndinë.

Vargu 17:

Luka 7:17 *'Dhe kjo e thënë (ky lajm) për të u përhap nëpër gjithë Judenë dhe anembanë krahinës përreth.'*

Nuk ngeli njeri pa e marrë vesh; ata nuk lanë njeri pa ia thënë. Djaloshi i vdekur, në funeralin në Nain, Jezusi e kishte kthyer përmbys funeralin. Ai e ktheu në jetë djalosin e vetëm të një nënë në Nain.

Miq, a besojmë se Jezusi mund të bëjë të pamundurën? A besojmë se Jezusi mund të bëjë edhe sot ato gjëra që thotë Bibla?

Cilat lutje po bën ti? **Lutje të vogla apo lutje të guximshme?**

Kjo është lutja ime për ty dhe për të gjithë personat e kishës: Që çdo herë që lexojmë apo dëgjojmë për Jezusin, të mbetemi me gojë hapur. Ajo që ka bërë Jezusi atëherë, do ta bëjë edhe sot dhe nesër. Ai është i njëjtë, dje, sot dhe përjetë.

Çfarë thoshin këta njerëz? Çfarë u thanë të tjerëve?

Nëse ti prisje një fjalë nga Perëndia sot, ajo mund të ishte:

"Unë kam bekime për jetën tënde që ti akoma nuk i ke marrë. Unë kam mrekulli për jetën tënde, gjëra që ty nuk të shkojnë mendja kurrë. Ji gjithmonë në pritje."

Le të jemi gjithmonë në pritje sa herë që lexojmë Biblën.

Le të jetojmë një jetë të rrezikshme, një jetë të zjarrtë, një jetë si ajo që Jezusi ka për secilin prej nesh.

Ji gjithmonë në pritje dhe kërkoji Atij:

"Jezus, çfarë do nga unë? Çfarë do nga grupi imi vogël? Jezus, çfarë do nga kjo kishë?"

Jezus, ajo që besojmë është: Nëse ecim me ty, nëse të dëgjojmë ty, nëse besojmë tek ty, ne kemi për të qenë të rrezikshëm, ashtu siç dëshiron ti që të jemi.

Le të lutemi.

Lutja e shpëtimit.